REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË 15408/4 Prot. 26.11.2020

Pol. Zhvill.

VENDIM

Nr. 925 **, datë** 25.11.2020

PËR

MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK "PËR PAJISJET E AEROSOLIT"[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit "Për pajisjet e aerosolit", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ky rregull teknik është i zbatueshëm për çdo pajisje aerosoli e vendosur në treg pas hyrjes në fuqi të tij .

3. Çdo pajisje aerosoli e vendosur në treg para hyrjes në fuqi të këtij rregulli nuk do të pengohet të bëhet e disponueshme në treg pas hyrjes në fuqi të këtij rregulli.

[1] Ky vendim është përafruar pjesërisht me Direktivën e Këshillit të datës 20 Maj 1975 për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me bombolat e aerosolit (75/324/EEC), versioni i konsoliduar i datës 12.02.2018

4. Ngarkohet Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ

RREGULL TEKNIK
"PËR PAJISJET E AEROSOLIT"

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky rregull teknik ka për qëllim vendosjen e rregullave të sigurisë teknike, të cilave duhet t'u nënshtrohen pajisjet aerosol, në mënyrë që të mbrohet shëndeti i njerëzve, mjedisit dhe interesi publik.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Dispozitat e këtij rregulli teknik nuk zbatohen për enët me kapacitet maksimal më të ulët se 50 ml dhe ato me kapacitet maksimal më të lartë se kapaciteti i përcaktuar respektivisht në nenin 13, nenin 16 dhe nenin 24 të këtij rregulli.

Neni 3
Përkufizime

Përveç përkufizimeve të dhëna në ligjin për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, për qëllim të këtij rregulli zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "Pajisje aerosoli" është çdo enë jo e ripërdorshme, e bërë nga metali, qelqi ose plastika që përmban gaz të kompresuar, të lëngëzuar ose të shpërbërë në presion të lartë, me ose pa përbërje lëngu, paste ose pluhuri, dhe e puthitur me një pajisje lëshuese që mundëson daljen e substancës së përmbajtur në formën e grimcave të ngurta ose të lëngëta, në gjendje të gaztë, shkume, paste, pluhuri ose të lëngët.

2. "Presione" janë trysnitë e brendshme të shprehura në bar (trysnitë relative).

3. "Presion testues" është presioni në të cilin një enë e pambushur e pajisjes së aerosolit vendoset për 25 sekonda pa pësuar asnjë rrjedhje ose, në rastin e pajisjeve metalike ose plastike, pa pësuar deformime të dukshme apo të përhershme, përveç atyre të lejuara sipas nenit 25 të këtij rregulli.

4. "Presion shpërthyes" është presioni minimal që shkakton shpërthimin ose çarjen e enës së pajisjes së aerosolit.

5. "Kapacitet total i enës" është vëllimi në mililitra të një ene të hapur deri në buzën (rrethin) e hapjes së enës.

6. "Kapacitet neto" është vëllimi në mililitra i një ene aerosoli të mbushur dhe të mbyllur.

7. "Vëllim i fazës së lëngët" është vëllimi i fazave jogazore në një pajisje të aerosoli të mbushur dhe të mbyllur.

8. "Kushtet e testimit" janë vlerat e testit dhe presionet shpërthyese të shkaktuara në mënyrë hidraulike në 20° C (± 5° C).

9. "Substancë" është substancë sipas përcaktimit të ligjit për menaxhimin e kimikateve.

10. "Përzierje" është përzierje sipas përcaktimit të ligjit për menaxhimin e kimikateve.

11. "Përmbajtje e ndezshme": Përmbajtja e aerosolit të konsiderohet e ndezshme nëse përmban ndonjë nga përbërësit e mëposhtëm që klasifikohet si i ndezshëm:

a) lëng i ndezshëm është një lëng me pikë flakërimi më të ulët se 93°C.

b) substancë e ngurtë e ndezshme është një substancë ose përzierje të ngurtë që është e djegshme ose mund të shkaktojë apo ndihmojë në ndezjen e zjarrit për shkak të fërkimit. Substancat e ngurta lehtësisht të djegshme janë substanca ose përzierje në formë pluhuri, granulare ose paste, që janë të rrezikshme nëse ndizen lehtësisht nga kontakti i shkurtër me një burim të ndezjes, të tillë si një shkrepëse e ndezur, dhe nëse flaka përhapet me shpejtësi.

c) gaz i ndezshëm është një gaz ose përbërje gazrash që ka pikë ndezjeje me ajrin në temperaturën 20°C dhe presion standard 1,013 bar.

Ky përkufizim nuk përfshin substanca dhe përzierje piroforike, me vetëngrohje dhe që reagojnë me ujin, të cilat nuk do të jenë asnjëherë pjesë përbërëse të aerosolit.

12. "Aerosolët e ndezshëm": Për qëllime të këtij Rregulli, një aerosol konsiderohet si 'i pandezshëm', 'i ndezshëm' ose 'shumë i ndezshëm' në varësi të nxehtësisë së tij kimike të djegies dhe sasisë së përbërësve të ndezshëm në të, si më poshtë:

a) Aerosoli klasifikohet si 'shumë i ndezshëm' nëse përmban 85% ose më tepër përbërës të ndezshëm dhe nxehtësia kimike e djegies është e barabartë ose më e lartë se 30 kJ/g;

b) Aerosoli klasifikohet si 'i pandezshëm' nëse përmban 1 % ose më pak përbërës të ndezshëm dhe nxehtësia kimike e djegies është më e ulët se 20 kJ/g;

c) Të gjithë aerosolët ose do t'u nënshtrohen procedurave të mëposhtme të klasifikimit të ndezshmërisë ose do të klasifikohen si 'shumë të ndezshëm'. Testi i distancës së ndezjes, testi në hapësirë të mbyllur dhe testi i ndezshmërisë së shkumës t'i përmbahen nenit 31, 35 dhe 38 të këtij Rregulli.

13. "Aerosolët e ndezshëm spraj": Në rastin e aerosolëve spraj, klasifikimi të bëhet duke marrë në konsideratë nxehtësinë kimike të djegies dhe duke u bazuar në rezultatet e testit të distancës së ndezjes, si më poshtë:

a) Nëse nxehtësia kimike e djegies është më e ulët se 20 kJ/g:

i) Aerosoli klasifikohet si 'i ndezshëm' nëse ndezja ndodh në një distancë të barabartë ose më të madhe se 15 cm por më të vogël se 75 cm;

ii) Aerosoli klasifikohet si 'shumë i ndezshëm' nëse ndezja ndodh në një distancë 75 cm ose më të madhe;

iii) Nëse nuk ndodh ndezje e aerosolit në testin e distancës së ndezjes, kryhet testimi në hapësirë të mbyllur dhe në këtë rast, aerosoli klasifikohet si 'i ndezshëm' nëse ekuivalenti kohor është i barabartë ose më i shkurtër se 300 s/m3 ose dendësia e djegies është më e ulët ose e barabartë me 300 g/m3; në të kundërt aerosoli klasifikohet si 'i pandezshëm'.

b) Nëse nxehtësia kimike e djegies është e barabartë ose më e lartë se 20 kJ/g, aerosoli klasifikohet si 'shumë i ndezshëm' nëse ndezja ndodh në një distancë 75 cm ose më të madhe; në të kundërt aerosoli klasifikohet si 'i ndezshëm'.

14. "Aerosolët e ndezshëm shkumë": Në rastin e aerosolëve shkumë, klasifikimi bëhet bazuar në rezultatet e testit të ndezshmërisë së shkumës.

a) Produkti aerosol klasifikohet si 'shumë i ndezshëm' nëse:

i) lartësia e flakës është 20 cm ose më shumë dhe kohëzgjatja e flakës është dy ose më shumë sekonda; ose

ii) lartësia e flakës është 4 cm ose më shumë dhe kohëzgjatja e flakës është shtatë ose më shumë sekonda.

b) Produkti i aerosolit që nuk përmbush kriteret në pikën (a) klasifikohet si i 'ndezshëm' nëse lartësia e flakës është 4 cm ose më shumë dhe kohëzgjatja e flakës është dy ose më shumë sekonda.

15. "Nxehtësia kimike e djegies": Nxehtësia kimike e djegies ΔHc përcaktohet nga:

a) rregullat e pranuara të teknologjisë, të përshkuara në standarde të tilla si ASTM D 240, ISO 13943 86.1 deri në 86.3 dhe NFPA 30B, ose të gjendura në literaturën shkencore; ose

b) zbatimi i metodës së mëposhtme të përllogaritjes: Nxehtësia kimike e djegies (ΔHc), në kiloxhaul për gram (kJ/g), mund të përllogaritet si prodhimi i nxehtësisë kimike teorike të djegies (ΔHcomb), dhe një vlerë të eficiencës së djegies, që zakonisht është më e vogël se 1,0 (vlera e zakonshme e eficiencës së djegies është 0,95 ose 95%).

Për një formulim të përbërë aerosoli, nxehtësia kimike e djegies është shuma e nxehtësive të peshuara të djegies për përbërësit individualë, si më poshtë:

$$\Delta H_c = \sum_{i}^{n} \left[w_i\% \times \Delta H_{c(i)} \right]$$

ku:

ΔHc = nxehtësia kimike e djegies (kJ/g) e produktit;

ëi% = fraksioni i masës së përbërësit në produkt;

ΔHc(i) = nxehtësia kimike specifike e djegies (kJ/g) e përbërësit i në produkt.

Neni 4
Bërja e disponueshme në treg dhe objektivat e sigurisë

1.Pajisja aerosol bëhet e disponueshme në treg vetëm nëse është prodhuar në përputhje me praktikat e sigurisë kimike dhe inxhinierike të këtij rregulli teknik, dhe nuk rrezikon shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, kafshëve shtëpiake ose pronës, kur instalohet, mirëmbahet dhe përdoret sipas qëllimit për të cilin është prodhuar.

2. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk ndalohet bërja e disponueshme në treg e pajisjes aerosol, që është në përputhje me këtë rregull teknik dhe kërkesat thelbësore të sigurisë të përcaktuara në shtojcën I të këtij rregulli.

KREU II
DETYRIMET E OPERATORËVE EKONOMIK

Neni 5
Detyrimet e prodhuesve

1. Kur prodhuesi vendos pajisjet e aerosolit në treg, ai siguron që ato janë projektuar dhe prodhuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull.

2. Prodhuesi harton dokumentacionin teknik dhe kryen procedurat e vlerësimit të konformitetit të zbatueshme ndaj pajisjeve të aerosolit, në bazë të ligjit për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore. Kur nga këto procedura rezulton përputhshmëria e produktit me kërkesat e zbatueshme, prodhuesi harton deklaratën EC të konformitetit dhe fikson markimin '3'(epsilon i përmbysur).

3. Pa rënë ndesh me kriteret me kriteret dhe procedurat e këtij rregulli teknik, që lidhen me rrezikun e ndezshmërisë dhe presionit, prodhuesi ka detyrimin të kryejë sipas rastit analizën, e cila përfshin një konsideratë për rreziqet që vijnë nga thithja përmes ajrit e sprajit të dalë nga enët e aerosolit në kushtet normale të parashikuara të përdorimit, duke marrë parasysh shpërndarjen e madhësisë së piklave lidhur me cilësitë fizike dhe kimike të përbërësve. Më pas, ai projekton, ndërton dhe teston dhe, sipas rastit, harton deklarata të veçanta lidhur me përdorimin e tyre, duke marrë në konsideratë analizën e tij.

4. Prodhuesi përshkruan metodën e ndjekur për përllogaritjen e nxehtësisë kimike të djegies në një dokument që duhet të jetë lehtësisht i disponueshëm në gjuhën shqipe në adresën e përcaktuar në etiketë në përputhje me pikën 1. a) të nenit 9 të këtij rregulli, nëse nxehtësia kimike e djegies përdoret si parametër për vlerësimin e ndezshmërisë së aerosolëve sipas dispozitave të këtij rregulli.

5. Prodhuesi siguron që shënimet në pajisjet e aerosolit të prodhuara prej tij, të lejojnë identifikimin e tij në çdo kohë. Prodhuesi vendos në enët e aerosolit ose etiketat e tyre emrin e tij, emrin ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën ku mund të kontaktohet.

6. Prodhuesi siguron që produkti të shoqërohet nga udhëzimet e përdorimit dhe informacioni për sigurinë, të cilat duhet të jenë në gjuhën shqipe, dhe në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga konsumatori ose përdoruesi i fundit.

7. Prodhuesit ruan dokumentacionin teknik të përcaktuar në këtë rregull teknik dhe deklaratën e konformitetit EU, për 10 vjet pasi pajisjet të jenë vendosur në treg.

8. Kur prodhuesi dyshon se pajisja që ai ka vendosur në treg mund të paraqesë rrrezik për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve, kryen testime të mostrave të pajisjeve të bëra të disponueshme në treg, heton dhe, nëse është e nevojshme, mban një regjistër të ankesave për pajisjet e aerosolit që nuk janë në konformitet dhe ato të kthyera nga përdoruesi i fundit, si dhe mban të informuar shpërndarësin për çdo monitorim të tillë.

9. Me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, i siguron asaj të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në letër ose formë elektronike, për demonstrimin e konformitetit të pajisjes e aerosolit të përcaktuar me këtë rregull, në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për këtë strukturë. Prodhuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për çdo masë të marrë për eleminimin e rrezikut të shfaqur nga pajisja e aerosolit e vendosur në treg prej tij.

Neni 6
Detyrimet e importuesit të pajisjeve të aerosolit

1. Importuesi vendos në tregun shqiptar vetëm pajisjet aerosoli që përputhen me këtë Rregull.

2. Përpara vendosjes në treg të pajisjeve të aerosolit, importuesi siguron se:

a) prodhuesi i ka kryer procedurat e duhura të vlerësimit të konformitetit dhe ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm teknik;
b) paisja ka dokumentacionin përkatës sipas pikave 2 dhe 3 të nenit 5
c) enët e aerosolit mbajnë markimin e kërkuar të konformitetit dhe shoqërohet nga dokumentacioni i kërkuar;
ç) prodhuesi ka zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 5 të këtij rregulli.

3. Nëse importuesi vlerëson ose dyshon që pajisjet e aerosolit që ai importon nuk janë në përputhje me këtë Rregull, ai nuk duhet të vendosë në treg ato deri në plotësimin e përputhshmërisë me kërkesat përkatëse. Në rast se pajisjet e aerosolit të importuara paraqesin rrezik, importuesi njofton menjeherë prodhuesin dhe strukturën përgjegjëse.

4. Kërkesat e vendosjes së emrit tregtar, adresës së kontaktit, udhëzimeve të përdorimit të përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të nenit 5, të këtij rregulli për prodhuesin, zbatohen njëlloj dhe për importuesin.

5. Importuesi siguron përputhshmërinë e kushteve të pajisjeve të aerosolit përgjatë transportit dhe magazinimit të tyre.

6. Me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, i siguron asaj të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në letër ose formë elektronike, për demonstrimin e konformitetit të pajisjes e aerosolit të përcaktuar me këtë rregull, në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për këtë strukturë. Importuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për çdo masë të marrë për eleminimin e rrezikut të shfaqur nga pajisja e aerosolit e vendosur në treg prej tij.

Neni 7
Detyrimet e shpërndarësit për bërjen e disponueshme në treg

1. Kur pajisja bëhet e disponueshme në treg, operatorët ekonomikë veprojnë me kujdesin e duhur në lidhje me respektimin e kërkesave të këtij rregulli.

2. Para bërjes së disponueshme në treg të pajisjes, shpërndarësi verifikon që:

   a) pajisja mban markimin '3'

   b) siguron që paisja ka dokumentacionin përkatës sipas pikave 2 dhe 3 të nenit 5

   c) pajisja shoqërohet me dokumentacionin e kërkuar, udhëzimet dhe informacionin për sigurinë në gjuhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë, dhe që,

   ç) prodhuesi dhe importuesi kanë plotësuar kërkesat e parashikuara në nenin 5, të këtij rregulli.

3. Kur shpërndarësi konsideron ose ka arsye për të besuar se pajisja nuk është në konformitet me objektivat e sigurisë, ai nuk duhet të bëjë të disponueshme në treg pajisjen, derisa ajo të sillet në konformitet me kërkesat ligjore të zbatueshme për të. Kur pajisja shfaq rrezik në treg, informon prodhuesin ose importuesin për rrezikun, si dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

4. Me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse, shpërndarësi i siguron asaj të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të demonstruar përputhshmërinë e pajisjes së aerosolit. Shpërndarësi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse, sipas kërkesës së saj, për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga pajisja e aerosolit e bërë e disponueshme në treg prej tij.

5. Kur provohet se, pavarësisht përputhshmërisë së pajisjeve të aerosolit me kërkesat thelbësore të përcaktuara në këtë rregull, ky produkt paraqet rrezik për sigurinë e jetës, shëndetit, mjedisit dhe interesave të tjerë publikë, struktura përgjegjëse u kërkon personave përgjegjës për tregtimin e pajisjeve të aerosolit të ndalojnë provizorisht shitjen e tyre ose u vendos kushte të veçanta, në përputhje me natyrën e rrezikut.

Neni 8
Rastet në të cilat detyrimet e shpërndarësit zbatohen për importuesin dhe prodhuesin

Importuesi ose prodhuesi konsiderohet shpërndarës, për qëllime të këtij rregulli, dhe i nënshtrohet detyrimeve të shpërndarësit sipas nenit 7, kur bën të disponueshme në treg një pajisje aerosoli ose, modifikon pajisjen të vendosur tashmë në treg në mënyrë të tillë që të ndikojë në përputhshmërinë e saj me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull.

Neni 9
Etiketimi

1. Çdo pajisje aerosoli ka të shënuar me shkronja të dukshme, të lexueshme dhe me bojë të përhershme, të dhënat e mëposhtme:

a) emrin dhe adresën ose markën e regjistruar e personit përgjegjës për tregtimin e pajisjeve të aerosolit,
b) simbolin '3' (epsilon i përmbysur) që vërteton zbatimin e kërkesave të këtij Rregulli,
c) kodin përkatës për të mundësuar identifikimin e vendit të mbushjes,
ç) detajet e përmendura në nenin 10 të këtij rregulli,
d) përmbajtja neto sipas peshës dhe vëllimit.

Kur këto të dhëna nuk mund të paraqiten në pajisjen e aerosolit për shkak të përmasave të vogla si në rastin e pajisjeve me kapacitet maksimal 150 ml ose më të ulët, pajisjes i vendoset një etiketë që i ka të shënuara këto të dhëna me shkronja të dukshme, të lexueshme dhe me bojë të përhershme.

2. Në rastin kur pajisja e aerosolit përmban elemente të ndezshme siç përcaktohet në pikën 11, të nenit 3 të këtij rregulli, por ena e aerosolit nuk konsiderohet "e ndezshme" ose "shumë e ndezshme" sipas kritereve të përcaktuara në pikën 11, të nenit 3 të këtij rregulli, sasia e materialit të ndezshëm që ndodhet në pajisjen e aerosolit përcaktohet qartë në etiketë, me shkronja të lexueshme dhe me bojë të përhershme, si më poshtë: 'X% e masës së përmbajtjes është e ndezshme'.

3. Tregtimi i pajisjeve të aerosolit në territorin e Republikës së Shqipërisë kushtëzohet me përdorimin e gjuhës shqipe në etiketa.

Neni 10
Fjalët paralajmëruese

1. Përveç rregullimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, çdo pajisjeje aerosoli duhet t'i vendoset shënimi i lexueshëm dhe me bojë të përhershme, si më poshtë:

a) fjala 'Kujdes' dhe elemente të tjera të etiketës për aerosolët e kategorisë 3, të paraqitur në seksionin 1.3 të shtojcës I dhe vendimit të Këshillit të Ministrave për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, kur aerosoli klasifikohet si i 'pandezshëm' në përputhje me kriteret e pikës 12 të nenit 3 të këtij rregulli.

b) fjala 'Kujdes' dhe elemente ë tjera të etiketës për aerosolët e kategorisë 2, të paraqitur në seksionin 1.3 të shtojcës I dhe vendimit të Këshillit të Ministrave për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, kur aerosoli klasifikohet si 'i ndezshëm' në përputhje me kriteret e pikës 12 të nenit 3 të këtij rregulli.

c) fjala 'Rrezik' dhe elemente të tjera të etiketës për aerosolët e kategorisë 1, të paraqitur në seksionin 1.3 të shtojcës I dhe vendimit të Këshillit të Ministrave për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, kur aerosoli klasifikohet si 'shumë i ndezshëm' në përputhje me kriteret e pikës 12, të nenit 3 të këtij rregulli.

ç) deklarata e kujdesit "Mbajeni larg fëmijëve", kur pajisja e aerosolit është produkt konsumator;

d) çdo paralajmërim tjetër përdorimi lidhur me rreziqet e produktit për konsumatorët; nëse pajisjet e aerosolit shoqërohen me udhëzime të veçanta përdorimi, këto të fundit duhet që të pasqyrojnë gjithashtu paralajmërimet e përdorimit.

Neni 11
Ndërtimi dhe pajisja

1. Enët e mbushura të aerosolit janë të tilla që, në kushte normale të përdorimit dhe të ruajtjes, u përmbahen dispozitave të këtij rregulli.

2. Valvula mundëson mbylljen hermetike të enës së aerosolit në kushte normale të ruajtjes ose transportit dhe është e mbrojtur, për shembull nëpërmjet një kapaku mbrojtës, në mënyrë që të mos ndodhë hapje e paqëllimshme apo dëmtim.

3. Sigurohet që nuk ka gjasa që rezistenca mekanike e enës së aerosolit të dëmtohet nga ndërveprimi i substancave në të, pavarësisht kohëzgjatjes së ruajtjes.

Neni 12
Vëllimi i fazës së lëngët

Vëllimi i fazës së lëngët në temperaturën 50 °C nuk duhet të tejkalojë 90% të kapacitetit neto.

KREU III
DISPOZITA TË VEÇANTA PËR ENËT METALIKE TË PAJISJES SË AEROSOLIT

Neni 13
Kapaciteti

Kapaciteti total i këtyre enëve nuk duhet të tejkalojë 1 000 ml.

Neni 14
Presioni testues i enës

1. Për enët e mbushura në presion më të ulët se 6·7 në temperaturën 50° C, presioni testues është i barabartë me minimumi 10 bar.

2. Për enët e mbushura në presion të barabartë ose më të lartë se 6·7 bar në temperaturën 50° C, presioni testues është të paktën 50% më i lartë se presioni i brendshëm në 50° C.

3. Presioni në 50° C i enës së aerosolit nuk duhet të tejkalojë vlerat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, në varësi të përbërjes së gazrave në enën e aerosolit:

Përbërja e gazrave	Presioni në 50° C.
Gaz i lëngshëm ose përbërje gazrash me pikë ndezjeje me ajrin në temperaturën 20°C dhe presion standard 1,013 bar	12 bar
Gaz i lëngshëm ose përbërje gazrash që nuk kanë pikë ndezjeje me ajrin në temperaturën 20 °C dhe presion standard 1,013 bar	13,2 bar
Gazra të kompresuar ose të shpërbërë në presion, që nuk kanë pikë ndezjeje me ajrin në temperaturën 20°C dhe presion standard 1,013 bar	15 bar

KREU IV
DISPOZITA TË VEÇANTA PËR ENËT E QELQTA TË AEROSOLIT

Neni 15
Enë me veshje plastike ose me mbrojtje të përhershme

Enët e këtij lloji mund të përdoren për t'u mbushur me gaz të kompresuar, të lëngëzuar ose të shpërbërë.

Neni 16
Kapaciteti

Kapaciteti total i këtyre enëve nuk duhet të tejkalojë 220 ml.

Neni 17
Veshja

Veshja formon një këllëf plastik ose me material tjetër të përshtatshëm, në mënyrë që të parandalojë gjasat e përhapjes së grimcave të qelqit nëse enët thyhet aksidentalisht, dhe krijohet në mënyrë të tillë që grimcat e qelqit të enës së mbushur të aerosolit, në temperaturën 20° C, të mos përhapen nëse enët bie nga një lartësi prej 1,8 m në dysheme.

Neni 18
Presioni testues i enës

1.Enët e përdorura për mbushje me gaz të kompresuar ose të shpërbërë i rezistojnë presionit testues të barabartë me të paktën 12 bar.

2. Enët e përdorura për mbushje me gaz të lëngët ose të shpërbërë i rezistojnë presionit testues të barabartë me të paktën 10 bar.

Neni 19
Mbushja

1. Enët e aerosolit të mbushura me gaz të kompresuar nuk parashikohet t'i rezistojnë presionit më të lartë se 9 bar në temperaturën 50 °C.

2. Enët e aerosolit të mbushura me gaz të shpërbërë nuk parashikohet t'i rezistojnë presionit më të lartë se 8 bar në temperaturën 50 °C.

3. Enët e aerosolit të mbushura me gaz të lëngët apo përzierje gazrash të lëngët nuk parashikohet t'u rezistojnë presioneve më të larta se ato të paraqitura në tabelën e mëposhtme në temperaturën 20° C:

Kapaciteti total	Përqindja sipas peshës së gazit të lëngëzuar në përzierjen totale		
	20 %	50 %	80 %
50 deri në 80 ml	3·5 bar	2·8 bar	2·5 bar
< 80 deri në 160 ml	3·2 bar	2·5 bar	2·2 bar
< 160 deri në 220 ml	2·8 bar	2·1 bar	1·8 bar

4. Tabela e dhënë në pikën 3 të këtij neni tregon kufijtë e lejuar të presionit në temperaturën 20°C në lidhje me përqindjen e gazit. Kufijtë e presionit për përqindjet e gazit, që nuk tregohen në tabelë, të përshtaten në përputhje me treguesit në tabelë (*aplikimi mutatis mutandis i treguesve te tabeles*).

Neni 20
Enët e pambrojtura të qelqit

Enët e aerosolit që përdorin enë të pambrojtura qelqi të mbushen vetëm me gazra të lëngët ose të shpërbërë.

Neni 21
Kapaciteti

Kapaciteti total i këtyre enëve nuk duhet të tejkalojë 150 ml.

Neni 22
Presioni testues

Presioni testues i enës duhet të jetë të paktën 12 bar.

Neni 23
Mbushja

1. Enët e aerosolit të mbushura me gaz të shpërbërë nuk parashikohet t'i rezistojnë presionit më të lartë se 8 bar në temperaturën 50° C.

2. Enët e aerosolit të mbushura me gaz të lëngët nuk parashikohet t'u rezistojnë presioneve më të larta se ato të paraqitura në tabelën e mëposhtme në temperaturën 20° C:

Kapaciteti total	Përqindja sipas peshës së gazit të lëngëzuar në përzierjen totale		
	20 %	50 %	80 %
50 deri në 70 ml	1·5 bar	1·5 bar	1·25 bar
< 70 deri në 150 ml	1·5 bar	1·5 bar	1 bar

3. Tabela në pikën 2 të këtij neni tregon kufijtë e lejuar të presionit në temperaturën 20°C në lidhje me përqindjen e gazit të lëngët. Kufijtë e presionit për përqindjet e gazit, që nuk tregohen në tabelë, të përshtaten në përputhje me treguesit në tabelë (*aplikimi mutatis mutandis i tregusve te tabeles*).

KREU V
DISPOZITA TË VEÇANTA PËR ENËT PLASTIKE TË AEROSOLIT

Neni 24
Enët plastike

1. Enët plastike të aerosolit që mund të ciflosen nga shpërthimi të trajtohen në të njëjtën mënyrë si enët e pambrojtura prej qelqi.

2. Enët plastike të aerosolit që nuk ciflosen nga shpërthimi të trajtohen në të njëjtën mënyrë si enët e aerosolit prej qelqi që kanë veshje mbrojtëse.

KREU VI
TESTET, KRITERET E PËRGJITHSHME TË TESTEVE

Neni 25
Testi hidraulik për enët bosh

1. Enët metalike, të qelqta ose plastike janë në gjendje të përballojnë testin e presionit hidraulik të përcaktuar në nenin 14, pikat 1 dhe 2, nenin 18 dhe nenin 22 të këtij rregulli.

2. Enët metalike që shfaqin deformime asimetrike ose të konsiderueshme, apo deformime të ngjashme, të refuzohen. Një deformimi i lehtë simetrik i bazës ose që ndodh në pjesën e jashtme mund të lejohet me kusht që ena të kalojë me sukses testin e shpërthimit.

Neni 26
Testi i shpërthimit për enët metalike bosh

Personi përgjegjës për prodhimin sigurohet që presioni shpërthyes i enëve është të paktën 20% më i lartë se presioni i përcaktuar.

Neni 27
Testi i rrëzimit për enët e qelqta të mbrojtura

Prodhuesi siguron që enët përmbushin kriteret e testimit të përcaktuara në nenin 17 të këtij rregulli.

Neni 28
Testimi përfundimtar i enëve të mbushura

1. Enët e aerosolit iu nënshtrohen një prej metodave të mëposhtme të testimit përfundimtar.

a) Testimi në vaskë me ujë të nxehtë: Çdo enë e mbushur zhytet në një vaskë me ujë të nxehtë.

i. Temperatura e vaskës me ujë dhe kohëzgjatja e testimit janë të tilla që presioni i brendshëm të arrijë atë presion që do të ushtrohet në përmbajtjen e tij në një temperaturë uniforme prej 50 °C.
ii. Çdo enë aerosoli që shfaq deformim të përhershëm të dukshëm ose rrjedhje refuzohet.

b) Metodat e testimit përfundimtar në të nxehtë: Për nxehjen e përmbajtjes së pajisjeve të aerosolit mund të përdoren edhe metoda të tjera, nëse ato garantojnë që presioni dhe temperatura në çdo enë të mbushur të arrijë vlerat e kërkuara për testimin në vaskë me ujë të nxehtë, dhe që të zbulohen deformimet dhe rrjedhjet me të njëjtën saktësi si në rastin e testimit në vaskë me ujë të nxehtë.

c) Metodat e testimit përfundimtar në të ftohtë: Si metodë alternative mund të përdoret edhe testimi përfundimtar në të ftohtë, nëse është në përputhje me dispozitat e një metode alternative ndaj testimit në vaskë me ujë të nxehtë për enët e aerosolit.

2. Për enët e aerosolit, përmbajtja e të cilave i nënshtrohet transformimit fizik ose kimik duke ndryshuar vetitë e tyre të presionit pas mbushjes dhe përpara përdorimit të parë, zbatohen metodat e testimit përfundimtar në të ftohtë në përputhje me pikën 1, shkronja "c", të këtij neni.

3. Në rastin e metodave të testimit sipas pikës 1 shkronjat "b" dhe "c", të këtij neni.

Vlerësimi i konformitetit të metodës së testimit kryhet nga një organ i miratuar në kuptim të ligjit për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

a) Ministri përgjegjës për tregtinë vepron si autoritet miratimi për organet e vlerësimit të konformitetit në kuptim të këtij Rregulli, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

b) Në parashikimet në vijim të këtij Rregulli, termi "organ" nënkupton një organizëm të notifikuar europian të miratuar ose një organ të miratuar shqiptar, të miratuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

c) Organi i vlerësimit të konformitetit paraqet një kërkesë për miratim tek autoriteti miratues në përputhje me të gjitha kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në këtë rregull teknik dhe legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 29
Testi për enët e pambushura

1. Presioni testues ushtrohet për 25 sekonda në pesë enët e përzgjedhura rastësisht nga një parti homogjene prej 2 500 enësh të pambushura, që do të thotë të prodhuara me të njëjtat materiale nga i njëjti proces i vazhdueshëm i prodhimit të partisë, ose nga një parti e prodhuar për një orë.

2. Nëse ndonjë prej këtyre pajisjeve nuk e kalon testin, të tërhiqen rastësisht dhjetë enë shtesë nga e njëjta parti dhe t'i nënshtrohen të njëjtit test.

3. Nëse ndonjë prej këtyre pajisjeve të aerosolit nuk e kalon testin, e gjithë sasia të shpallet e papërshtatshme për përdorim.

Neni 30
Testet për enët e mbushura me aerosol

Testet për papërshkueshmërinë e ujit dhe ajrit kryhen nëpërmjet zhytjes së një kampioni përfaqësues të pajisjeve të mbushura me aerosol në një vaskë me ujë të nxehtë. Temperatura e ujit të vaskës dhe periudha e zhytjes janë të tilla që bëjnë të mundur që përmbajtja e enës së aerosolit të arrijë një temperaturë uniforme prej 50° C gjatë kohës së kërkuar, për të garantuar që të mos ketë shpërthim ose çarje.

Çdo parti e pajisjeve të aerosolit që nuk i kalon këto teste konsiderohet e papërshtatshme për përdorim.

Neni 31
Testi i distancës së ndezjes për aerosolët spraj

1. Ky standard testimi përshkruan metodën për të përcaktuar distancën e ndezjes së një spraj aerosoli me qëllim vlerësimin e rrezikut shoqërues për të marrë flakë. Pajisja e aerosolit spërkatet në drejtim të burimit të ndezjes në intervale prej 15 cm për të vënë re nëse ndodh ndezja dhe djegia e pandërprerë e sprajit. Ndezja dhe djegia e pandërprerë përcaktohet kur ruhet një flakë e qëndrueshme për të paktën pesë sekonda. Burimi i ndezjes përcaktohet si një djegës gazi me flakë ngjyrë blu pa shkëlqim, me lartësi 4-5 cm.

2. Ky test aplikohet për produkte aerosoli me distancë spërkatjeje prej 15 cm ose më të madhe. Produkte aerosoli me distancë spërkatjeje prej më pak se 15 cm, si ato që përhapin shkumë, musë, xhel dhe pastë, ose të inkorporuara me një valvul matëse, të përjashtohen nga ky test. Produktet e aerosolit që përhapin shkumë, musë, xhel ose pastë iu nënshtrohen testimit sipas testit për ndezshmërinë e shkumës së aerosolit.

3. Për testimin e ndezjes në distancë të produkteve të aerosolit kërkohen aparatet dhe instrumentat matës të mëposhtëm , që janë të kalibruar periodikisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi:

a) Vaskë uji me temperaturë 20 °C — e saktë ± 1 °C
b) Peshore laboratori e kalibruar — e saktë ± 0,1 g
c) Kronometër — i saktë ± 0,2 s
ç) Metër i shkallëzuar, mbështetëse dhe kapëse — shkallëzime në cm
d) Djegës gazi me mbështetëse dhe kapëse
dh) Termometër — i saktë ± 1 °C
e) Higrometër — i saktë ± 5 %
ë) Matës presioni — i saktë ± 0,1 bar

Neni 32
Procedurat dhe kërkesat e përgjithshme për testimin e pajisjeve të aerosolit

1. Përpara testimit, çdo enë aerosoli të kondicionohet dhe përgatitet nëpërmjet shkarkimit për afërsisht një sekondë. Qëllimi i këtij veprimi është të hiqet materiali johomogjen nga tubi zhytur.

2. Udhëzimet e përdorimit ndiqen në mënyrë strikte, duke përfshirë faktin nëse synohet që ato të përdoren në pozicion vertikal ose të përmbysur. Kur nevojitet që të tundet, tundet menjëherë përpara testimit.

3. Testimi të kryhet në një mjedis pa ajër me mundësi ventilimi, me temperaturë të kontrolluar në 20 °C ± 5 °C dhe lagështirë relative në diapazonin 30-80 %.

4. Çdo enë aerosoli të testohet kur:

a) është e mbushur sipas procedurës së plotë, nëpërmjet djegësit të gazit në distancën me diapazon 15-90 cm nga lëshuesi i shishes së aerosolit;
b) është nominalisht 10-12 % e mbushur (% sipas masës) vetëm një test, qoftë në distancën 15 cm nga lëshuesi kur spraji nga një shishe e mbushur nuk ndizet fare, ose në distancën e ndezjes së sprajit të një shisheje të mbushur plus 15 cm.

5. Gjatë testit, shishja e aerosolit të vendoset siç tregohet në udhëzimet në etiketë. Burimi i ndezjes të vendoset sipas rastit.

Neni 33
Procedurat për testimin e sprajit

1. Qëllimi i procedurës është të përcaktojë distancën maksimale ndërmjet lëshuesit të aerosolit dhe flakës së djegësit që sjell djegien e pandërprerë të sprajit, ose për të përcaktuar që ndezja nuk mund të arrihet në distancën 15 cm ndërmjet flakës së djegësit dhe lëshuesit të aerosolit.

2. Procedura e mëposhtme kërkon testimin e sprajit në intervale prej 15 cm ndërmjet flakës së djegësit dhe lëshuesit të aerosolit, në diapazonin 15-90 cm. Është efikase që të fillojë në distancë 60 cm ndërmjet flakës së djegësit dhe lëshuesit të aerosolit. Distanca ndërmjet flakës së djegësit dhe lëshuesit të aerosolit të rritet me 15 cm në rastin e djegies së sprajit në distancë 60 cm. Distanca të ulët me 15 cm në rast se nuk ka ndezje në distancën 60 cm ndërmjet flakës së djegësit dhe lëshuesit të aerosolit.

3. Procedura e testimit bëhet në përputhje me pikën 1.1 të shtojcës 1 të këtij rregulli.

4. Të gjitha eksperimentet të kryhen në një kabinet me avull, në një dhomë që mund të jetë e mirëajrosur. Ventilimi i kabinetit me avull dhe dhomës mund të zbatohet për të paktën tre minuta për secilin test. Merrni të gjitha masat e nevojshme të sigurisë për të parandaluar thithjen e produkteve të djegies.

5. Shishet me nivel mbushës nominal 10-12 % të testohen vetëm një herë. Tabelat e rezultateve kanë vetëm një rezultat për shishe të treguar.

6. Kur testi në pozicionin që është parashikuar të përdoren enët jep një rezultat negativ, testi të përsëritet në pozicionin sipas të cilit enët kanë më shumë gjasa të sjellin një rezultat pozitiv.

Neni 34
Metoda e vlerësimit të rezultateve

Të gjitha rezultatet regjistrohen në modelin e 'tabelës së rezultateve' të dhënë në pikën 1.2 të shtojcës 1 të këtij rregulli.

Neni 35
Testi i ndezjes në hapësirë të mbyllur

1. Ky standard testimi përshkruan metodën për vlerësimin e ndezshmërisë së produkteve që lind nga enët e aerosolit për shkak të tendencës së tyre për të marrë flakë në një hapësirë të mbyllur ose izoluar. Përmbajtja e enës së aerosolit të spërkatet në një enë testimi cilindrike që përmban një qiri të ndezur. Nëse ndodh një ndezje e dukshme, të mbahet shënim koha e kaluar dhe sasia e shkarkuar.

2. Për kryerjen e testimit kërkohen aparatet dheinstrumentat matës të mëposhtëm , që janë të kalibruar periodikisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi:

a) Kronometër i saktë ± 0,2 s
b) Vaskë uji me temperaturë 20 °C e saktë ± 1 °C
c) Peshore laboratori e kalibruar e saktë ± 0,1 g
ç) Termometër i saktë ± 1 °C
d) Higrometër i saktë ± 5 %
dh) Matës presioni i saktë ± 0,1 bar
e) Enë testimi cilindrike siç detajohet në pikën 3 të këtij neni.

3. Përgatitja e aparatit testues bëhet duke marrë një enë cilindrike me vëllim rreth 200 dm3, me diametër rreth 600 mm dhe me gjatësi rreth 720 mm, të hapur në njërin skaj, e cila modifikohet në përputhje me përcaktimet e pikës 2.1 të shtojcës 1 të këtij rregulli.

4. Zakonisht, produkti hiqet nga shishja e aerosolit në një kënd prej 90°, pozicion që përkon me boshtin vertikal të shishes. Skica dhe procedura e përshkruar i referohet këtij lloji produkti aerosoli. Në rast të aerosolëve operuese të pazakonshme si në rastin e pajisjeve të aerosolit me spërkatje vertikale, do të nevojitet regjistrimi i ndryshimeve në pajisje në përputhje me ISO/IEC 17025.

Neni 36
Procedura dhe kërkesa të përgjithshme për kapacitetet e laboratorëve të testimit dhe kalibrimit.

1. Përpara testimit, çdo enë aerosoli të kondicionohet dhe më pas të përgatitet duke e zbrazur për rreth 1 sekondë. Qëllimi i këtij veprimi është të hiqet materiali johomogjen nga tubi zhytur.

2. Udhëzimet e përdorimit ndiqen në mënyrë strikte, duke përfshirë faktin nëse synohet që ato të përdoren në pozicion vertikal ose të përmbysur. Kur nevojitet që të tundet, tundeni menjëherë përpara testimit.

3. Testet të kryhen në një mjedis pa ajër me mundësi ventilimi, me temperaturë të kontrolluar në 20 °C ± 5 °C dhe lagështirë relative në diapazonin 30-80 %.

4. Procedura e testimit u përmbahet rregullave të përcaktuara në pikën 2.2 të shtojcës 1 të këtij rregulli.

Neni 37
Metoda e vlerësimit të rezultateve

Për çdo test hartohet një raport, që të përmbajë informacionin e treguar në pikën 2.3 të Shtojcës 1 të këtij rregulli.

Neni 38
Testi i ndezshmërisë së shkumës së aerosolit

1. Ky standard testimi përshkruan metodën për të përcaktuar ndezshmërinë e një spraji aerosoli të emetuar në formën e shkumës, musës, xhelit ose pastës. Aerosoli, që emeton shkumë, musë, xhel ose pastë, spërkatet (afërsisht 5 g) në një mbajtëse qelqi për eksperimente, dhe burimi i ndezjes (qiri, ngjitës dylli, shkrepëse ose çakmak) vendoset në fund të mbajtëses së qelqit për të vëzhguar nëse ndodh ndezja dhe djegia e pandërprerë e shkumës, musës, xhelit ose pastës. Ndezja përcaktohet si flakë e pandërprerë që vijon për të paktën dy sekonda dhe me lartësi minimale 4 cm.

2. Për kryerjen e testimit kërkohen aparatet dheinstrumentat matës të mëposhtëm , që janë të kalibruar periodikisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi:

a) Peshore e shkallëzuar
b) Mbështetëse dhe kapëse
c) Shkallëzime në cm
ç) Mbajtëse qelqi rezistente ndaj zjarrit me diametër afërsisht 150 mm
d) Kronometër i saktë ± 0,2 s Qiri,
dh) Ngjitës dylli, shkrepëse ose çakmak
e) Peshore laboratori e kalibruar e saktë ± 0,1 g
ë) Vaskë me ujë në temperaturë 20 °C e saktë ± 1 °C
f) Termometër i saktë ± 1 °C

g) Higrometër i saktë ± 5 %
gj) Matës presioni i saktë ± 0,1 bar

3. Mbajtësja e qelqit vendoset në një sipërfaqe rezistente ndaj zjarrit brenda hapësirës pa ajër, e cila mund të ventilohet pas çdo testi. Peshorja e shkallëzuar të vendoset saktësisht pas mbajtëses së qelqit dhe të mbahet në pozicion vertikal nëpërmjet një mbështetëseje dhe kapëse.

4. Peshorja të vendoset në mënyrë të atillë që baza e saj të jetë në të njëjtin nivel me bazën e mbajtëses së qelqit në planin horizontal.

Neni 39
Procedura dhe kërkesa të përgjithshme të testimit

1. Përpara testimit, çdo enët aerosoli të kondicionohet dhe më pas të përgatitet duke e zbrazur për rreth 1 sekondë. Qëllimi i këtij veprimi është të hiqet materiali johomogjen nga tubi zhytur.

2. Udhëzimet e përdorimit ndiqen në mënyrë strikte, duke përfshirë faktin nëse synohet që ato të përdoren në pozicion vertikal ose të përmbysur. Kur nevojitet që të tundet, tundeni menjëherë përpara testimit.

3. Testet të kryhen në një mjedis pa ajër me mundësi ventilimi, me temperaturë të kontrolluar në 20 °C ± 5 °C dhe lagështirë relative në diapazonin 30-80 %.

4. Procedura e testimit kryhet duke ndjekur hapat e përcaktuar pikën 3.1 të shtojcës 1 të këtij rregulli.

Neni 40
Metoda e vlerësimit të rezultateve të testimit

Për çdo testim hartohet një raport, që të përmbajë informacionin e treguar në pikën 3.2 të shtojcës 1 të këtij rregulli.

SHTOJCA 1

PROCEDURAT E TESTIMIT DHE METODAT E VLERËSIMIT

1. Procedura për testimin e sprajit

1.1. Procedurat për testimin e sprajit ndjek hapat e mëposhtëm:

a) Minimalisht 3 enë të mbushura të pajisjes aerosol për produkt të kondicionohen në temperaturë 20 °C ± 1 °C, ku të paktën 95 % e enës të zhytet në ujë për minimalisht 30 minuta përpara secilit test (nëse aerosoli është plotësisht i zhytur, mjaftojnë 30 minuta kondicionim);

b) Respektoni kërkesat e përgjithshme. Regjistroni temperaturën dhe lagështirën relative të mjedisit;

c) Peshoni një enë aerosoli dhe shënoni masën e saj.

ç) Përcaktoni presionin e brendshëm dhe normën fillestare të shkarkimit në temperaturën 20 °C ± 1 °C (për të eliminuar enët me defekt ose pjesërisht të mbushura të pajisjes së aerosolit);


d) Mbështeteni djegësin e gazit në një sipërfaqe horizontale të sheshtë ose fiksojeni djegësin në një mbështetëse nëpërmjet një kapëseje;

dh) Ndizeni djegësin e gazit; flaka të jetë jo me shkëlqim dhe afërsisht 4-5 cm e lartë;

e) Vendoseni grykën dalëse të lëshuesit në distancën e kërkuar nga flaka. Aerosoli testohet në pozicionin e parashikuar për t'u përdorur, p.sh., vertikalisht ose i përmbysur;

ë) Niveloni grykën e lëshuesit dhe flakës së djegësit, duke garantuar që gryka të drejtohet si duhet dhe të orientohet drejt flakës (shihni Figurën 1). Nxjerrja e sprajit drejtohet në gjysmën e sipërme të flakës së djegësit;

Figura. 1



f) Respektoni kërkesat e përgjithshme lidhur me tundjen e enës;

g) Lëshoni valvulën e enës së aerosolit për të zbrazur përmbajtjen e saj për pesë sekonda, nëse nuk ndodh ndezja. Nëse ndodh ndezja, vijoni me shkarkimin dhe matni kohëzgjatjen e flakës për pesë sekonda, që nga fillimi i ndezjes;

gj) Shënoni rezultatet e ndezjes për distancën ndërmjet djegësit të gazit dhe enës së aerosolit në tabelën e dhënë;

h) Nëse gjatë hapitsipas shkronjws g nuk ndodh ndezja, aerosoli testohet në orientime alternative, p.sh., i përmbysur për produktet me përdorim vertikal, për të kontrolluar nëse arrihet ndezja;

i) Përsëritni hapat sipas shkronjave "e" deri në "h" edhe dy herë (3 herë në total) për të njëjtën shishe, në të njëjtën distancë ndërmjet djegësit të gazit dhe lëshuesit të aerosolit;

j) Përsëriteni procedurën e testimin edhe për dy shishe aerosoli të të njëjti produkt, në të njëjtën distancë ndërmjet djegësit të gazit dhe lëshuesit të aerosolit;

k) Përsëritni hapat sipas shkronjave "e" deri në "j" të procedurës së testimit, në të njëjtën distancë ndërmjet 15 dhe 90 cm, ndërmjet lëshuesit të shishes së aerosolit dhe flakës së djegësit mbi rezultatin e secilit test (shihni edhe pikat 4 dhe 5 të nenit 30 të këtij Rregulli).o

l) Nëse në distancën 15 cm nuk ndodh ndezja, procedura përfundon për shishet fillimisht të mbushura. Procedura përfundon edhe kur ndezja dhe djegia e pandërprerë arrihet në distancën prej 90 cm. Nëse ndezja nuk mund të arrihet në distancën 15 cm, mbani shënim që nuk ndodhi ndezja. Distanca maksimale ndërmjet flakës së djegësit dhe lëshuesit të aerosolit për të cilën është vënë re ndezja dhe djegia e pandërprerë shënohet si 'distanca e ndezjes', në gjitha rrethanat e tjera.

ll) Një test kryhet edhe për tre shishe me nivel mbushës nominal 10-12%. Këto shishe testohen në një distancë ndërmjet lëshuesit të aerosolit dhe flakës së djegësit të 'distancës së ndezjes së flakës për shishet e mbushura + 15 cm';

m) Zbrazeni një shishe aerosoli deri në nivelin mbushës nominal prej 10-12 % (sipas masës) me djegie prej 30 sekondash maksimumi. Vini re një periudhë kohore minimale prej 300 sekondash ndërmjet djegieve. Gjatë kësaj periudhe të përkohshme, enët të vendosen në vaskën me ujë për kondicionim;

n) Përsëritni hapat sipas shkronjave "e" deri në "j" për shishet e aerosolit me mbushje nominale prej 10-12 %, duke shmangur hapat sipas shkronjave "h" dhe "i". Ky test të kryhet vetëm me aerosol në një pozicion, p.sh., vertikal ose i përmbysur, që përkon me atë që ka prodhuar ndezjen (nëse ka) për shishet e mbushura;

nj) Regjistrojini të gjitha rezultatet në tabelën e dhënë në pikën 1.2 të shtojcës 1 të këtij rregulli.

1.2. Metoda e vlerësimit të rezultateve

Data		Temperatura … °C Lagështira relative … %		
Emri i produktit				
Vëllimi neto		Ena 1	Ena 2	Ena 3
Niveli fillestar i mbushjes		%	%	%
Distanca e enës	Testi	1 2 3	1 2 3	1 2 3
15 cm	Ndezje? Po ose Jo			
30 cm	Ndezje? Po ose Jo			
45 cm	Ndezje? Po ose Jo			
60 cm	Ndezje? Po ose Jo			
75 cm	Ndezje? Po ose Jo			
90 cm	Ndezje? Po ose Jo			
Vëzhgime — duke përfshirë pozicionin e shishes				


2. Testi i ndezjes në hapësirë të mbyllur

2.1. Përgatitja e aparatit testues bëhet duke marrë një enë e cila modifikohet si më poshtë:

a) Një sistem mbylljeje i një mbulese të varur i vendoset skajit të hapur të enës; ose

b) Si sistem mbylljeje mund të përdoret një shtresë e hollë plastike me trashësi 0,01 deri në 0,02 mm. Nëse testi kryhet me një shtresë të hollë plastike, kjo përdoret siç përshkruhet më poshtë: Tendoseni shtresën e hollë mbi skajin e hapur të enës cilindrike dhe mbajeni aty me një fashë elastike. Forca e fashës është e tillë që kur të vendoset përreth enës cilindrike duke qëndruar në anë të saj, ajo të tendoset vetëm 25 mm kur i bashkëngjitet një masë prej 0,45 kg në pikën e saj më të ulët. Bëni një prerje 25 mm në shtresën e hollë, duke filluar 50 mm nga skaji i enës cilindrike. Sigurohuni që shtresa e hollë të jetë e tendosur;


Figura 2



c) Në skajin tjetër të enës cilindrike hapni një vrimë me diametër 50 mm 100 mm nga skaji, në mënyrë të atillë që gryka të jetë sipër kur ena vendoset horizontalisht dhe është gati për testim (Figura 2);


ç) Në një mbështetëse metalike 200 × 200 mm vendosni një qiri parafine me diametër 20 deri në 40 mm dhe lartësi 100 mm. Qiriri të vendoset kur lartësia është më e ulët se 80 mm. Flaka e qiririt të mbrohet nga spërkatja nëpërmjet një reflektori 150 mm të gjerë dhe 200 mm të lartë. Kjo përfshin planin me pjerrësi 45° të krijuar 150 mm nga baza e reflektorit (Figura 3);

Figura 3



d) Qiriri i vendosur mbi një mbështetëse metalike të vendoset ndërmjet dy skajeve të enës cilindrike (Figura 4);

Figura 4



dh) Ena cilindrike të vendoset në tokë ose mbi një mbështetëse në një vend ku temperatura të jetë ndërmjet 15 °C dhe 25 °C. Produkti për testim do të spërkatet brenda enës cilindrike afërsisht 200 dm3 në të cilën do të jetë burimi i ndezjes.

2.2. Procedura e testimit u përmbahet rregullave të mëposhtme:

a) Minimalisht 3 enë të mbushura të pajisjes aerosol për produkt të kondicionohen në vaskë me ujë të nxehtë në temperaturë 20 °C ± 1 °C, ku të paktën 95 % e enës të zhytet në ujë për minimalisht 30 minuta (nëse aerosoli është plotësisht i zhytur, mjaftojnë 30 minuta kondicionim);

b) Matni ose përllogaritni vëllimin aktual të enës cilindrike në dm3;

c) Respektoni kërkesat e përgjithshme. Regjistroni temperaturën dhe lagështirën relative të mjedisit;

ç) Përcaktoni presionin e brendshëm dhe normën fillestare të shkarkimit në temperaturën 20 °C ± 1 °C (për të eliminuar enët me defekt ose pjesërisht të mbushura të pajisjes së aerosolit);

d) Peshoni një nga enët e aerosolit dhe shënoni masën e saj;

dh) Ndizni qiririn dhe përdorni sistemin e mbylljes (mbulesë ose shtresë e hollë plastike);

e) Vendoseni grykën e lëshuesit të enës së aerosolit 35 mm ose më afër për një produkt me spërkatje me distancë të madhe, nga qendra e vrimës hyrëse në enën cilindrike. Filloni kronometrimin dhe ndiqni udhëzimet për përdorimin e produktit; drejtojeni sprajin drejt qendrës së skajit të kundërt (mbulesë ose shtresë e hollë). Aerosoli të testohet në pozicionin e parashikuar për përdorim, p.sh., vertikal ose i përmbysur;

ë) Spërkatni derisa të ndodh ndezja. Ndaloni kronomentrimin dhe mbani shënim kohën e harxhuar. Ripeshoni enën e aerosolit dhe shënoni masën e saj.

f) Ventiloni dhe pastroni enën cilindrike, duke hequr çdo mbetje që ka gjasa të ndikojë në testimet pasardhëse. Nëse është e nevojshme, lëreni enën cilindrike të ftohet;

g) Përsëritni hapat sipas shkronjave " ç" deri në "g" të procedurës së testimit edhe për dy enët aerosoli të të njëjtit produkt (tre në total, mbani parasysh: çdo enët aerosoli të testohet vetëm një herë);

2.3. Raporti përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) Produktin e testuar dhe referencat e tij;
b) Presionin e brendshëm dhe normën e shkarkimit të enës së aerosolit;
c) Temperaturën dhe lagështirën relative të ajrit në dhomë;
ç) Për secilin test, kohën e nevojshme të shkarkimit për të arritur ndezjen (nëse produkti nuk ndizet, pohojeni këtë);
d) Masën e produktit të spërkatur gjatë secilit test (në g);
dh) Vëllimin aktual të enës cilindrike (në dm3).

2. Ekuivalenti kohor (t_{eq}) i nevojshëm për të arritur ndezjen në një metër kub mund të përllogaritet si më poshtë:

$$t_{eq} = \frac{1000 \text{ x koha e shkarkimit (s)}}{\text{Vëllimi aktual i enës cilindrike } (dm^3)}$$

3. Dendësia e nevojshme e djegies në çast (D_{def}) për të arritur ndezjen gjatë testit mund të përllogaritet si më poshtë:

$$D_{def} = \frac{1000 \text{ x Koha e produktit të përhapur (g)}}{\text{Vëllimi aktual i enës cilindrike } (dm^3)}$$

3. Testi i ndezshmërisë së shkumës së aerosolit

3.1. Procedura e testimit kryhet sipas hapave të mëposhtëm:

a) Minimalisht katër enë të mbushura të pajisjes aerosol për produkt të kondicionohen në temperaturë 20 °C ± 1 °C, ku të paktën 95 % e enës të zhytet në ujë për minimalisht 30 minuta përpara secilit test (nëse aerosoli është plotësisht i zhytur, mjaftojnë 30 minuta kondicionim);

b) Respektoni kërkesat e përgjithshme. Regjistroni temperaturën dhe lagështirën relative të mjedisit;

c) Përcaktoni presionin e brendshëm në temperaturën 20°C ± 1 °C (për të eliminuar enët me defekt ose pjesërisht të mbushura të pajisjes së aerosolit);

ç) Matni shkarkimin ose normën e rrjedhjes së produktit të aerosolit për t'u shqyrtuar, në mënyrë që sasia e produktit të testimit të përhapur të matet më saktë;

d) Peshoni një nga enët e aerosolit dhe shënoni masën e saj;

dh) Mbështetur në shkarkimin ose normën e matur të rrjedhjes dhe në zbatim të udhëzimeve të prodhuesit, hidhni rreth 5 g të produktit në qendër të mbajtëses së pastër të qelqit, me qëllim krijimin e një pirgu jo më të lartë se 25 mm;

e) Brenda pesë sekondash nga përfundimi i shkarkimit, përdorni burimin e ndezjes në skaj të kampionit në bazën e tij, dhe në të njëjtën kohë filloni kronometrimin. Nëse është e nevojshme, burimi i ndezjes të largohet nga skaji i kampionit pas afërsisht dy sekondash, për të parë qartësisht nëse ka ndodhur ndezja. Nëse nuk vihet re ndezja e kampionit, burimi i ndezjes të ripërdoret në skajin e kampionit;

ë) Nëse ndodh ndezja, mbani shënim pikat e mëposhtme:

i. Lartësinë maksimale të flakës në cm mbi bazën e mbajtëses që qelqit;
ii. Kohëzgjatjen e flakës në s;
iii. Thani dhe ripeshoni enën e aerosolit, dhe përllogaritni masën e produktit të zbrazur;

f) Ventiloni zonën e testimit menjëherë pas çdo testi;

g) Nëse nuk arrihet ndezja dhe produkti i çliruar mbetet në formën e shkumës ose pastës gjatë gjithë periudhës së përdorimit, të përsëriten hapat sipas shkronjave "d" deri në "f". Përpara përdorimit të burimit të ndezjes, lëreni produktin për 30 sekonda, 1 minutë, 2 minuta ose 4 minuta;

gj) Përsëritni edhe dy herë hapat "d" deri në "g" të procedurës së testimit (3 herë në total) për të njëjtën shishe;

h) Përsëritni hapat sipas shkronjave "e" deri në "gj" të procedurës së testimit edhe për dy shishe aerosoli (3 shishe në total) për të njëjtin produkt.

3.2. Raporti përmban informacionin e mëposhtëm:

a) nëse ndizet produkti;
b) lartësinë maksimale të flakës në cm;
c) kohëzgjatjen e flakës në s;
ç) masën e produktit të testuar.

NR.PROT. 5822/1
DATË 26.11.2020

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MBIKËQYRJES SË TREGUT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI